

## INFORMATA MBI GRANTIN

|  |  |
|--|--|
| <b>Instrumenti:</b>  | Grant Institucional  |
| <b>Subjekti zbatues:</b>                                   | Organizata Kosovare për Talent dhe Arsim - TOKA  |
| <b>Kontaktet (adresa, emaili, telefoni, website):</b>      | Rr. Meto Bajrakatari, nr.4-1, Prishtinë<br>info@toka-ks.org<br>+383 38 704 560<br><a href="http://www.toka-ks.org">www.toka-ks.org</a>   |
| <b>Kohëzgjatja e grantit:</b>                              | Data e fillimit: 01.01.2025<br>Data e përfundimit: 31.12.2027  |
| <b>Buxheti i përgjithshëm i organizatës(EUR):</b>          | EUR 665,160.00   |
| <b>Buxheti i mbështetur nga programi EJA Kosovë (EUR):</b> | EUR 119,758.80   |
| <b>Grupet e synuara:</b>                                   | <ul style="list-style-type: none"> <li>• Gratë</li> <li>• Rinia</li> </ul>   |
| <b>Shtrirja gjeografike:</b>                               | Në gjithë Kosovën  |
| <b>Përmbledhje e grantit:</b>                              | <p>Qëllimi i TOKA-s është të fuqizojë të rinjtë të cilët vijnë nga zona të pafavorshme, për t'u bërë agjentë të ndryshimit pozitiv - sot dhe nesër. Përmes këtij granti TOKA synon të arrijë këto rezultate specifike: Fuqizimin e fëmijëve dhe të rinjve - përmes programeve të edukimit joformal, vullnetarizmit dhe pjesëmarrjes më të gjerë demokratike. Ngritjen e kapaciteteve të liderëve të të rinjve - përmes trajnimit dhe mentorimit liderët vullnetarë do të ofrojnë udhëheqje dhe mbështetje për të rinjtë në komunitetet e tyre. Përmirësimin e ekosistemit të Kosovës për edukimin e të rinjve, vullnetarizmin dhe pjesëmarrjen më të gjerë demokratike - përmes avokimit dhe partneritetit me institucione për ligje, politika dhe praktika më të mira. Mobilizimi i akterëve joqeveritar (p.sh. sektori privat dhe diaspora) për të rritur kontributin e tyre për një ekosistem më të qëndrueshëm për edukimin e të rinjve, vullnetarizmin dhe pjesëmarrjen më të gjerë demokratike. Përmirësimi i ekosistemit rajonal për edukimin e të rinjve, vullnetarizmin dhe pjesëmarrjen më të gjerë demokratike - përmes avokimit dhe iniciativave të përbashkëta me OSHC-të me mendësi progresive në rajon dhe Evropë. Ndërsa aktivitetet kryesore janë: Angazhimi i të rinjve me institucione dhe zgjerimin e qytetarisë aktive tek të rinjtë në nivel lokal dhe qendror. Organizimi i Çmimit dhe Konferencës Vjetore "Vullnetari i Vitit"; Organizimi i tryezave të rrumbullakëta vjetore me institucionet përkatëse për të adresuar prioritetet dhe pengesat për pjesëmarrje dhe aktivizëm qytetar më të madh të të rinjve; Sigurimi i mbështetjes vjetore financiare dhe kontribut në mall për aktivizmin rinor</p> |

Bashkëfinancuar nga:



Schweizerische Eidgenossenschaft  
Confédération suisse  
Confederazione Svizzera  
Confederaziun svizra

Swiss Agency for Development  
and Cooperation SDC



Suedia  
Sverige

|  |  |
|--|--|
|  | <p>nga institucionet dhe bizneset; Promovimi i bashkëpunimit dhe solidaritetit rajonal nëpërmjet iniciativave të përbashkëta rajonale, duke përfshirë Çmimin Rajonal të Vullnetarizmit Edukativ. Parimi i shtrirjes gjeografike është i thjeshtë - ne i takojmë target grupet tona aty ku janë. Përfituesit tanë vijnë nga 15+ komuna të Kosovës - dhe këtu ne i mbështesim ata. Ndryshimi kryesor që pritet në fund të periudhës së grantit është që të ketë një ekosistem më të gjerë dhe më të qëndrueshëm për pjesëmarrjen dhe qytetarinë aktive të të rinjve në Kosovë.</p> |
|--|--|